

“Të rinjtë në Shqipëri” dhe “Mplakja e popullsisë”

Fjala e hapjes

Tiranë, më 25 Nëntor 2015: Të nderuar pjesëmarrës, në emër të Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT, z. Gjergji Filipi ju uroj mirëseardhjen.

Instituti i Statistikave (INSTAT) prezanton sot për herë të parë dy botime të reja, botime të cilat i shtohen gamës së analizave të thelluara që INSTAT ka kryer bazuar në rezultatet e Censusit të Popullsisë dhe Banesave 2011. Botimet analitike mbi Mplakjen e popullsisë dhe Të rinjtë në Shqipëri, janë realizuar falë ndihmës dhe bashkëpunimit të ngushtë që INSTAT ka patur me UNFPA – Fondin e Kombeve të Bashkuara për Popullsinë dhe SDC- Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Këto analiza janë kryer me ndihmën bashkëpunimin e ngushtë të ekspertëve të INSTAT dhe ekspertit ndërkombëtar Bart de Brujin, të cilin gjej rastin ti falenderoj.

Analizat e thelluara me titull: “Mplakja e Popullsisë: Situata e të moshuarve në Shqipëri”, dhe “Të Rinjtë në Shqipëri: Sfidat në kohët që ndryshojnë” do të shërbejë më së miri për të pasur një vlerësim më të qartë të jetesës së të moshuarve të grupmoshës 65 vjeç e lart dhe jetesës së të rinjve shqiptarë, të grupmoshës 15 deri në 29 vjeç.

Gjatë dy dekadave të fundit vendi ka përjetuar një transformin të thellë demografik i cili është shoqëruar me një rritje të numrit të personave 65 vjeç e lart, i shoqëruar nga një rënie e numrit të fëmijëve dhe të rinjve. Për të rinjtë e kësaj grupmoshe, kjo periudhë përkon me ngjarje të rëndësishme, si përfundimi i shkollimit, tranzicionin nga shkolla në tregun e punës, martesat dhe krijimi i familjes, seksualitetin, etj. Sjellja dhe vendimet e përfshira në këto përvoja dhe ngjarje shpesh paraqesin sfida sociale dhe ekonomike për të rinjtë.

Shoqëria shqiptare dhe politikë-bërësit duhet të jenë të mirë përgatitur për këto fenomene, të cilët do të japin impaktin e tyre në dekadat që vijnë në fushën social-ekonomike.

Po paraqesim për publikun disa nga gjetjet më interesante të këtyre studimeve;

Mplakja e popullsisë, çfarë u vu re nga studimi i këtij grupi të popullsisë:

Së pari, gjatë dy dekadave 1989-2011 numri i personave të moshuar është dyfishuar. Nëse ky trend do të vazhdonte me këto ritme pritet që në vitin 2031, një e treta e popullsisë do të ishte mbi 65 vjeç, ku si arsye kryesore vërehet rritja e jetëgjatësisë në lindje.

Përsa i përket jetesës së personave të moshuar në këndvështimin e përbërjes familjare, vihet re një tendencë në rënie e bashkëjetesës me fëmijët e tyre.

Pa dashur të zbuloj gjetjet e shumta të këtij botimi, të cilat janë pjesë e prezantimeve përkatëse vlen të përmendet se një risi e këtij publikimi është edhe llogaritja e Indeksit të Vëzhgimit të Mplakjes, kuptimi i të cilit u paraqit dhe u shpjegua për herë të parë në këtë botim.

Gjithashtu u përlogarit edhe Indeksi i Vulnerabilitetit të personave 65 vjeç e lart i ilustruar gjeografikisht.

Ndërsa përsa i përket botimit, Të Rinjtë në Shqipëri vërejmë se ky studim është munduar të prekë të gjitha fushat e jetës së të rinjve, duke shfrytëzuar të gjitha burimet në dispozicion, burime të INSTAT dhe jo vetëm ato të Censurit.

Do të doja të theksoja se disa nga gjetjet e këtij botimi është llogaritja për herë të parë e indeksit të jetëgjatësisë së shkollimit, indeks ky i rëndësishëm që publikohet nga Eurostatat për të gjitha vendet anëtare të BE.

Statistikat sociale janë një instrument mjaft i rëndësishëm për të kuptuar mirë gjendjen e shoqërisë shqiptare. Gjej rastin nga kjo konferencë, për të shprehur vullnetin dhe gatishmërinë e palëkundur të INSTAT për rritur edhe më tej bashkëpunimin me shoqërinë civile, mjedisin akademik, organizata të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, për t'i servirur publikut shqiptar studime të tilla të thelluara, të cilat kontribuojnë në kuptimin dhe shpjegimin më të mirë të fenomeneve të ndryshme sociale apo ekonomike që ndodhin në vendin tonë.